U D H Ë Z I M

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.465, DATË 3.7.2003 "PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I MODERNIZIMIT TË AGJENCISË NACIONALE TË TRAFIKUT AJROR SHA"

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003 "Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i modernizimit të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror sh.a., Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit

U D H Ë Z O J N Ë:

1. Në zbatim të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003, punonjësit që dalin të papunë, si pasojë e procesit të modernizimit të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror sh.a., Tiranë, trajtohen financiarisht për një periudhë 2-vjeçare në masën 100% të pagës bazë mujore, të shtesës së vjetërsisë në punë dhe për sigurimet e detyrueshme, në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Pagesa e punonjësve sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003, bëhet nga zyra e punësimit të vendbanimit të punonjësve, vetëm pas paraqitjes së listave të punonjësve nga drejtoria përkatëse.

3. Periudha 2-vjeçare konsiderohet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Në zbatim të kësaj pike personat përfitues kanë të drejtën e trajtimit me pagesë papunësie, pas përfundimit të trajtimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003.

4. Të drejtën e trajtimit sipas kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 3.7.2003 e kanë të gjithë ata punonjës të cilët vërtetojnë se nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formë punësimi ose vetëpunësimi. Çdo person është i detyruar të paraqesë vërtetim nga dega e tatim-taksave të rrethit ku ka vendbanimin. Personat që vetëpunësohen ose punësohen gjatë periudhës së trajtimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003, duhet të bëjnë deklaratë në zyrën e punësimit për të ndërprerë pagesën, në të kundërt detyrohen të zhdëmtojnë shumën e përfituar padrejtësisht.

5. Për të përfituar të drejtën e trajtimit sipas kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003, punonjësit që dalin të papunë duhet të paraqesin në zyrën përkatëse të punësimit këto dokumente:

- Librezën e punës ku të shkruhet shkaku i ndërprerjes:"Dalje i papunë nga procesi i modernizimit të shoqërisë ANTA sh.a., Tiranë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003". Libreza e punës të jetë e vulosur nga titullari i shoqërisë.
- Vërtetim nga organet tatimore të rrethit ku të shënohet nëse punonjësi kryen ose jo aktivitet privat.
- Certifikatën e gjendjes familjare.

6. Pagesat për punonjësit realizohen me listëpagesa të veçanta në datat e përcaktuara nga zyrat e punësimit.

7. Në rast mosparaqitjeje të përfituesit në datën e caktuar, paga e tij arkëtohet jo më vonë se brenda 5 ditëve, duke filluar nga data e kryerjes në fakt të pagesave.

8. Fondet financiare të nevojshme për kryerjen e këtyre pagesave, sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 datë 3.7.2003, do të transferohen nga ANTA sh.a. në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo 2 muaj. Transferimi i fondeve të bëhet 2 javë para datës së vendosur për kryerjen e pagesave nga zyra e punësimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Valentina Leskaj MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE SOCIALE	**Arben Malaj** MINISTËR I EKONOMISË
Spartak Poçi	

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE I TELEKOMUNIKACIONIT